



Republika e Kosovës

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 143/14

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum 26.06.2014

VUSHTRRI - VUČITRN



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **26.06.2014**, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Buxhetore 2015-2017 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 01/2015 të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit


Shpetim Zhegrova

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN
REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 147/14

Nr. i fq. / Br. si -1-

Data: / Datum 26.06.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 dhe 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 26.06.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDËRTIMIN E ÇESHMES PUBLIKE NË SHESHIN E QYTETIT

Neni 1

Me këtë vendim aprovet ndërtimi i çeshmes publike në sheshin e qytetit afër parkut dhe shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari, gjegjësisht në hapësirën ku është rrënuar ish-objekti i njohur si "Shpëtia e Partizanit".

Neni 2

Mjetet financiare për ndërtimin e çeshmes publike të përmendur në nenin 1 të këtij vendimi i bart qytetari në cilësinë e donatorit nga Ankaraja e Turqisë Mustafa Genç.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorja për Shërbime Publike.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	146/14
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	26.06.2014
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 26.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË BIZNESEVE NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

Neni 1

Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet "Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Vushtrrisë" nr. 272/10, të datës 30 Dhjetor 2010, gjegjësisht nenit 15.1, neni 15.2 plotësohet dhe ndryshohet si dhe shtohet neni 15.3, si në vijim:

15.1.Orari i punës për barnatore, ordianca, laboratorë, rëntgen, shërbimet e ultrazërit, shërbimet stomatologjike dhe klinika private mund të jetë prej orës 07:00 deri në ora 23:00.

15.2 Barnaret që veprojnë në Komunën e Vushtrrisë janë të obliguara të kujdestarojnë 24:00 orë non-stop, në pajtim me planin hartuar për kujdestari. Plani për kujdestari hartohet nga përfaqësuesit e barnatoreve dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, si dhe azhurohet çdo tre muaj.

15.3 Pjesë e planit për kujdestari janë të gjitha barnaret që veprojnë në Komunën e Vushtrrisë. Plani për kujdestari nënshkruhet nga Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, i cili iu dërgohet: QKMF-së, Emergjencës, dhe të gjitha barnatoreve si dhe organeve të tjera që vlerësohen të rëndësishme për interesin e qytetarëve.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale dhe Drejtoria për Inspektim.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-GPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 145/14

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 26.06.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/1202 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **26.06.2014**, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 24/14, DT. 30.01.2014

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01 Nr. 24/14, dt. 30.01.2014, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon: në paragrafin 1.1, nënpika 2 në vend të Besart Shaqiri, Komandant i stacionit policor, duhet të jetë: **Komandanti i Stacionit Policor në Vushtrri.**

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 144 / 14

Nr. i fq. / Br. sh -1-

Data: / Datum 26.06.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 26.06.2014, pas shqyrtimit të Draft-Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë për periudhën 2014-2020 në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

VEN D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë për periudhën 2014-2020 në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 26.06.2014 dhe zgjatë deri më 18.07.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer m masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-planit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-statutit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Korrik 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova